


PHILIPS

BASS+

On-ear

TABH305



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni mbështetje teknike në
www.philips.com/support

Përmbajtja

1	Udhëzime të rëndësishme sigurie	2
	Siguria për dëgjimin	2
	Informacione të përgjithshme	2
2	Kufja juaj me Bluetooth	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Pajisje të tjera	3
	Përmbledhje për kufjen me Bluetooth	3
3	Fillimi	4
	Karikimi i kufjes	4
	Çiftojeni kufjen me telefonin celular	4
4	Përdorimi i kufjes	5
	Lidheni kufjen me një pajisje Bluetooth	5
	Menaxhimi i telefonatave dhe muzikës	5
	Vendosja e kufjeve në kokë	6
5	Të dhëna teknike	7
6	Njoftim	8
	Njoftim pajtueshmërie	8
	Deklarata e konformitetit	8
	Hedhja e produktit dhe baterisë të vjetër	8
	Markat tregtare	9
7	Pyetje të bëra shpesh	10

1 Udhëzime të rëndësishme sigurie

Siguria për dëgjimin



Rrezik

- Për të shmangur dëmtimin në dëgjim, kufizoni kohën që e përdorni kufjen me volum të lartë dhe vendoseni volumin në një nivel të sigurt. Sa më i lartë të jetë volumi, aq më e shkurtër të jetë koha e dëgjimit.

Sigurohuni të ndiqni udhëzimet e mëposhtme kur e përdorni kufjen.

- Dëgjoni me volum të arsyeshëm për periudha kohe të arsyeshme.
- Bëni kujdes të mos e ngrini vazhdimisht volumin derisa veshi juaj të përshtatet me volumin.
- Mos e ngrini volumin kaq shumë saqë të mos dëgjoni çfarë ka rreth jush.
- Duhet të bëni kujdes ose të mos e përdorni përkohësisht në situata që mund të jenë të rrezikshme.
- Presioni i tepërt i tingullit nga kufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.
- Përdorimi i kufjeve me të dy veshët e mbuluar gjatë drejtimit të automjetit nuk rekomandohet dhe mund të jetë i jashtëligjshëm në disa zona.
- Për sigurinë tuaj, shmangni përqendrimet nga muzika ose telefonatat ndërsa jeni në trafik ose në ambiente që mund të jenë të rrezikshme.

Informacione të përgjithshme

Për të shmangur dëmtimet ose defektet:



Kujdes

- Mos e ekspozoni kufjen në nxehtësi ekstreme
- Mos e rrëzoni kufjen.
- Kufjet nuk duhet të ekspozohen ndaj spërkatjeve ose lëngjeve.
- Mos lejoni që kufjet të zhyten në ujë.
- Mos përdorni agjentë pastrimi që përmbajnë alkool, amoniak, benzen ose gërryes.
- Nëse është e nevojshme ta pastroni, përdorni një leckë të butë të njomur me sasi minimale uji ose detergjent të butë.
- Bateria e brendshme nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësive të tepërta si për shembull drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria nuk vendoset si duhet. Ndërroni vetëm duke përdorur të njëjtin tip baterie.
- Asnjëherë mos i përdorni kufjet kur përdorni një automjet motorik, kur ngisni biçikletën, kur vraponi ose kur ecni në zona me lëvizje. Është e rrezikshme dhe e jashtëligjshme në shumë vende.

Të dhëna rreth temperaturave dhe lagështisë për operimin dhe ruajtjen

- Temperatura e operimit: 0°C (32°F) deri në 40°C (104°F)
- Temperatura e ruajtjes: -10°C (14°F) deri në 45°C (113°F)
- Lagështia e operimit: 8% - 90% RH (Pa kondensim)
- Lagështia e ruajtjes: 5% - 90% RH (Pa kondensim)
- Lartësia maksimale e operimit: 3000m
- Jetëgjatësia e baterisë mund të jetë më e shkurtër në kushte temperature të lartë ose të ulët.

2 Kufja juaj me Bluetooth

Urime për blerjen, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfutur plotësisht nga ajo që ofron Philips, regjistroni produktin tuaj në

www.philips.com/welcome.


Me këtë kufje Philips me valë, ju mund të:

- bëni telefonata pa duar;
- dëgjoni dhe kontrolloni muzikën me valë;
- kaloni mes telefonatave dhe muzikës.
- kënaqeni me anulimin e zhurmës.

Çfarë ka në kuti



Kufje Philips me Bluetooth TABH305



Kabllo i karikimit me USB (vetëm për karikim)





Manuali i përdorimit

Pajisje të tjera

Një celular ose pajisje portative (p.sh. Notebook, PDA, adaptorë Bluetooth, aparate MP3, etj.) që mbështet Bluetooth dhe është i pajtueshëm me kufjen (shiko “Të dhëna teknike” në faqen 7).

Përmbledhje për kufjen me Bluetooth



- ① Treguesi LED
- ② (Ndezje/Fikje/Çiftim)
- ③ Mikrofon
- ④ Vendi i karikimit Micro USB
- ⑤ Treguesi LED për anulimin aktiv të zhurmës (ANC)
- ⑥ Butoni i ndezjes/fikjes për anulimin aktiv të zhurmës (ANC)
- ⑦ Butoni i kontrollit të volumit / këngës
- ⑧ Butoni MFB (kontrolli i muzikës / telefonatës)

3 Fillimi

Karikimi i kufjes

Shënim

- Para se ta përdorni kufjen për herë të parë, karikoni baterinë për një orë e gjysmë për kapacitet dhe jetëgjatësi optimale të baterisë.
- Përdorni vetëm kabllin origjinal USB të karikimit për të shmangur çfarëdo dëmtimi.
- Mbaroni telefonatën para se ta karikoni kufjen, pasi lidhja e kufjes për karikoni kufjen pasi karikimi do ta fikë kufjen.

Lidhni kabllin USB të karikimit që ju është dhënë me:

- vendin e karikimit micro USB në kufje dhe;
 - karikuesin/portën USB të një kompjuteri
- ↳ Drita LED ndizet në ngjyrë të bardhë dhe fiket kur kufja është karikuar plotësisht.

Këshillë

- Normalisht, karikimi i plotë zgjat 2 orë.



Çiftoteni kufjen me telefonin celular

Para se ta përdorni kufjen me celularin për herë të parë, çiftoteni me një telefon celular. Një çiftim i suksesshëm bën të mundur një lidhje unike të enkriptuar mes kufjes dhe telefonit celular. Kufja ruan 8 pajisjet e fundit në memorie. Nëse mundoheni të çiftoni më shumë se 8 pajisje, pajisja e çiftuar e para zëvendësohet me atë më të fundit.

- 1 Sigurohuni që kufjet janë karikuar plotësisht.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur butonin  për 2 sekonda për ta ndezur kufjen.
- 3 Aktivizoni veçorinë Bluetooth të celularit tuaj.
 - ↳ Për çiftimin e pajisjes së mëparshme, pajisja do të çiftohet automatikisht me kufjen. Do të dëgjohej një zë "Pajisja u lidh".
 - ↳ Për çiftimin e pajisjes së re, zgjidhni Philips TABH305 në celularin tuaj, dhe pajisja do të çiftohet me kufjen. Do të dëgjohej një zë "Pajisja u lidh". Për informacione të hollësishme, shikoni manualin e celularit tuaj.

Shembulli i mëposhtëm ju tregon si ta çiftoni kufjen me celularin tuaj.

- 1 Aktivizoni veçorinë Bluetooth të celularit tuaj, zgjidhni Philips TABH305.
- 2 Vendosni fjalëkalimin e kufjes "0000" (4 zero) nëse kërkohet. Për telefonat celularë me Bluetooth 3.0 ose më të lartë, nuk ka nevojë të vendosni një fjalëkalim.



4 Përdorimi i kufjes

Lidheni kufjen me një pajisje Bluetooth

- 1 Ndizni celularin/pajisjen Bluetooth.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur butonin  për 2 sekonda për ta ndezur kufjen.
 - ↳ Drita LED e bardhë pulson
 - ↳ Më pas, drita LED blu pulson, dëgjohe zëri "Pajisja u lidh".
 - ↳ Kufja lidhet përsëri automatikisht me telefonin celular/pajisjen Bluetooth që ishte lidhur për herë të fundit. Nëse pajisja e fundit nuk është e disponueshme, kufja përpiqet të lidhet përsëri me pajisjen e lidhur për herë të parafundit.

Këshillë

- Nëse celulari/pajisja Bluetooth nuk mund të rilidhen automatikisht, provoni ta rilidhni manualisht duke klikuar emrin e kufjes përsëri në konfigurimin manual të Bluetooth në celularin/pajisjen Bluetooth.
- Për ta fshirë listën e pajisjeve të çiftuara në kufjen tuaj, shtypni butonin MFB (kontrolli i muzikës / telefonatës) për më shumë se 10 sekonda.

Shënim

- Nëse kufja nuk lidhet me asnjë pajisje Bluetooth për 5 minuta, ajo do të fiket automatikisht për të kursyer baterinë.

Menaxhimi i telefonatave dhe muzikës

Ndezje/fikje

Detyra	Butoni	Përdorimi
Ndizni kufjen.	 (Ndezja/fikja/çiftimi)	Shtypni dhe mbajeni shtypur për 2 sekonda.
Fikeni kufjen.	 (Ndezja/fikja/çiftimi)	Shtypni dhe mbajeni shtypur për 5 sekonda. ↳ Drita LED e bardhë ndizet dhe zbehet.

Kontrolli i muzikës

Detyra	Butoni	Përdorimi
Luani ose ndaloni muzikën.	MFB (Kontrolli i muzikës/telefonatës)	Shtypni një herë.
Ngritja e volumnit.	Kontrolli i volumnit/këngës 	Shtypni një herë.
Ulja e volumnit.	Kontrolli i volumnit/këngës 	Shtypni një herë.
Kënga tjetër.	Kontrolli i volumnit/këngës 	Shtypje e gjatë.
Kënga e mëparshme.	Kontrolli i volumnit/këngës 	Shtypje e gjatë.

Kontrolli i telefonatës

Detyra	Butoni	Përdorimi
Përgjigjuni/mbylleni një telefonatë.	Butoni MFB (kontrolli i muzikës/telefonatës)	Shtypni një herë. ↳ 1 bip.
Refuzoni një telefonatë hyrëse.	Butoni MFB (kontrolli i muzikës/telefonatës)	Shtypni një herë. ↳ 1 bip.

Detyra	Butoni	Përdorimi
Kaloni te telefonuesi tjetër gjatë një telefonate.	Butoni MFB (kontrolli i muzikës/ telefonatës)	Shtypje e gjatë
Heshtni/ hapni mikrofoni në një telefonatë.	Butoni MFB (kontrolli i muzikës/ telefonatës)	Shtypeni tre herë. ↳ 2 bipe

Kontrolli i zërit


Detyra	Butoni	Përdorimi
Siri/Google Voice	Butoni MFB (kontrolli i muzikës / telefonatës)	Shtypje e gjatë

Status tjetër tregues i kufjes

Statusi i kufjes	Treguesi
Kufjet janë të lidhura me një pajisje Bluetooth, ndërkohë që kufjet janë në modalitetin në pritje ose ndërsa dëgjoni muzikë.	Drita LED blu pulson çdo 8 sekonda.
Kufjet janë gati për çiftim.	Drita LED pulson ngjyrë blu dhe të bardhë me radhë.
Kufjet janë të ndezura por nuk janë të lidhura me pajisjen Bluetooth.	Drita LED blu puls on shpejt nëse nuk mund të bëhet asnjë lidhje, dhe kufja fiket vetë brenda 5 minutash.
Nivel i ulët i baterisë	Drita LED e bardhë pulson dy herë çdo 150 sekonda derisa t'i mbarojë energjia.
Bateria është e karikuar plotësisht.	Drita LED e bardhë është e fikur.

Vendosja e kufjeve në kokë

Rregulloni rripin sipas kokës.



Këshillë

- Pas përdorimit, palosini kufjet për t'i vendosur.

5 Të dhëna teknike

- Koha e muzikës (ANC e aktivizuar me Bluetooth): 15 orë
- Koha e bisedës (ANC e aktivizuar me Bluetooth): 15 orë
- Koha në pritje (ANC e aktivizuar me Bluetooth): 15 orë
- Koha normale për një karikim të plotë: 2 orë
- Bateri e rikarikueshme me polimere litiumi (530 mAh)
- Mbështetje Bluetooth 4.2, Bluetooth mono (Profil i kufjes - HSP, Profil pa përdorim duarsh - HFP), Mbështetje Bluetooth Stereo (Profil i shpërndarjes audio të avancuar - A2DP; Profil për kontroll në distancë të audio-videos-AVRCP)
- Gama e frekuencës: 2.402-2.480GHz
- Fuqia e transmetuesit: ≤4dBm
- Porta Micro-USB për karikim
- Mbështet SBC
- Gama e operimit: Deri në 10 metra (33 këmbë)
- Reduktim i ekos dhe zhurmës digjitale
- Paralajmërim për bateri të ulët: i disponueshëm
- 18 orë kohë luajtjeje me BT të ndezur dhe ANC të fikur



Shënim

- Specifikimet mund të ndryshohen pa u njoftuar.

6 Njoftim

Njoftim pajtueshmërie

Njoftim për SHBA

Pajisja i përmbahet rregullave FCC, pjesa 15. Operimi është subjekt i dy kushteve të mëposhtme:

- ① Kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe
- ② Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojë operim të padëshiruar.

Rregullat FCC

Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje digjitale të Kategorisë B, sipas pjesës 15 të rregullave FCC. Këto limite janë bërë për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencës së dëmshme në një ambient banimi. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji frekuence radioje dhe, nëse nuk instalohet dhe përdoret në përputhje me manualin e udhëzimeve, mund të shkaktojë interferencë të dëmshme ndaj komunikimeve radio.

Sidoqoftë, nuk ka garanci se interferenca nuk do të ndodhë në një ambient të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferenca të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë që mund të përcaktohet duke e fikur dhe ndezur pajisjen, përdoruesi nxitet që të përpiqet ta korrigjojë interferencën me një ose më shumë prej masave të mëposhtme:

- Zhvendos antenën marrëse.
- Rritni hapësirën mes pajisjes dhe marrësit
- Lidhni pajisjen me një prizë në një qark elektrik që është ndryshe nga ai që është lidhur marrësi.
- Konsultohuni me shitësin ose me një teknik të kualifikuar të radiove/televizorëve për ndihmë.

Deklarata e FCC për ekspozimin ndaj rrezatimit:

Kjo pajisje i përmbahet limiteve të FCC për ekspozimin ndaj rrezatimit të përcaktuar për një mjedis të pakontrolluar. Ky transmetues nuk duhet të vendoset së bashku me një antenë ose transmetues tjetër ose të punojë së bashku me to.

Njoftim për Kanadanë:

Kjo pajisje i përmbahet Standardit RSS të Industry Canada licence-exempt. Operimi është subjekt i dy kushteve të mëposhtme: (1) kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe (2) kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë operim të padëshiruar. CAN ICES-3(B)/NMB-3(B)

Deklarata e IC për ekspozimin ndaj rrezatimit:

Kjo pajisje i përmbahet limiteve të Kanadasë për ekspozimin ndaj rrezatimit të përcaktuar për mjedise të pakontrolluara. Ky transmetues nuk duhet të vendoset së bashku me një antenë ose transmetues tjetër ose të punojë së bashku me to.

Kujdes: Përdoruesi paralajmërohet se ndryshimet ose modifikimet që nuk janë miratuar shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjnë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për të operuar pajisjen.

Deklarata e konformitetit

Këtu, MMD Hong Kong Limited deklaroi se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.p4c.philips.com.

Hedhja e produktit dhe baterisë të vjetër

Ky produkt mund të përmbajë plumb dhe merkur. Hedhja e këtyre materialeve mund të rregullohet nga përshak të konsideratave mjedisore. Për informacione lidhur me hedhjen ose riciklimin, ju lutem kontaktoni

autoritetet lokale ose vizitoni

www.recycle.philips.com.

Ky produkt përmban bateri që nuk mund të hiqen:

- Mos e digjni. Bateritë mund të pëlcasin nëse nxehen tepër.
- Për informacione lidhur me hedhjen ose riciklimin, ju lutemi kontaktoni autoritetet lokale ose vizitoni www.recycle.philips.com.



Produkti juaj është ndërtuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë me cilësi të lartë të cilët mund të riciklohen dhe të ripërdoren.




Ky simbol në një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban një bateri të rikarikueshme të brendshme që mbulohet nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU e cila nuk mund të hidhet së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Ju këshillojmë fort që ta çoni produktin në një pikë zyrtare grumbullimi ose në një qendër shërbimi Philips për ta hequr baterinë e rikarikueshme në mënyrë profesionale. Informohuni lidhur me sistemin e grumbullimit të veçantë në zonën tuaj për produktet elektrike dhe elektronike dhe bateritë e rikarikueshme. Ndiqni rregullat lokale dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë e rikarikueshme së bashku me mbeturinat e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra dhe e baterive të rikarikueshme ndihmon në parandalimin e pasojave negative ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Nëse në vendin tuaj nuk ka sistem grumbullimi/riciklimi për produktet elektronike, mund ta mbronj mjedisin duke hequr dhe ricikluar baterinë para se t'i hidhni kufjet.



Markat tregtare

Bluetooth

Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe përdorimi i çdo marke të tillë nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë. Markat dhe emrat tregtarë të tjerë janë të pronarëve të tyre përkatës.

Heqja e baterisë së brendshme

Shënim

- Sigurohuni që kufjet janë të shkëputura nga kablli i karikimit USB para se ta hiqni baterinë.

7 Pyetje të bëra shpesh

Kufjet e mia me Bluetooth nuk ndizen.
Niveli i baterisë është i ulët. Karikoni kufjet.

Nuk mund t'i lidh kufjet me një telefon celular.
Bluetooth është i çaktivizuar. Aktivizoni veçorinë Bluetooth në celularin tuaj dhe ndizni celularin pasi ta ndizni kufjen.

Çiftimi nuk punon.
Sigurohuni që kufja në është në modalitetin e çiftimit.

- Ndiqui hapat e përshkruar në këtë manual përdorimi.

Telefoni celular nuk e gjen dot kufjen.

- Kufjet mund të jenë lidhur me një pajisje të çiftuar më parë. Fikeni pajisjen e lidhur ose largojeni nga rrezja.
- Çiftimi mund të jetë fshirë ose kufjet janë çiftuar më parë me një pajisje tjetër. Çiftojeni përsëri kufjen me celularin siç tregohet në manualin e përdorimit.

Kufjet e mia me Bluetooth janë lidhur me një telefon celular me Bluetooth stereo, por muzika luhet vetëm në boksën e celularit tim.
Shikoni manualin e përdorimit të celularit. Zgjidhni të dëgjoni muzikë përmes kufjes.

Telefonimi me zë ose ritefonimi nuk punon në celularin tim.
Celulari juaj nuk e mbështet këtë veçori.

Ana tjetër nuk mund të më dëgjojë në celular.
Mikrofoni është heshtur. Shtypni butonin MFB (kontrolli i muzikës / telefonatës) tre herë për ta aktivizuar mikrofonin.

Cilësia e audios është e dobët dhe mund të dëgjohet zhurmë kërcitjeje.
Pajisja Bluetooth është jashtë rrezes. Afroni kufjen dhe dhe pajisjen Bluetooth, ose largoni pengesat mes tyre.

Cilësia e audios është e dobët kur streaming nga celulari është shumë i ngadaltë, ose streaming audio nuk punon fare. Sigurohuni që celulari juaj mbështet jo vetëm (mono) HSP/HFP por edhe A2DP (shiko të 'Të dhëna teknike' në faqen 7).

Dëgjoj por nuk mund ta kontrolloj muzikën në pajisjen time Bluetooth (p.sh. luaj/pauzë/ kapërce përpara/ mbrapa).
Sigurohuni që burimi audio Bluetooth mbështet AVRCP (shiko 'Të dhëna teknike' në faqen 7).

Për ndihmë të mëtejshme, vizitoni www.philips.com/support.



Este equipamento não tem direito à proteção contra interferência prejudicial e não pode causar interferência em sistemas devidamente autorizados.

Este produto está homologado pela ANATEL, de acordo com os procedimentos regulamentados pela Resolução 242/2000, e atende aos requisitos técnicos aplicados. Para maiores informações, consulte o site da ANATEL: www.anatel.gov.br

Philips dhe logoja me mburojën Philips janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. Dhe përdoren me licencë.

Ky produkt prodhohet dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited dhe ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

UM_TABH305_10_EN_v3.0

